



**Deklaratë për shtyp -**

## **Dhjetë stimuj nga qeveria e Republikës për të forcuar aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin**

**Kryeministri Laschet: Paketa efektive e stimullit ekonomik duhet të ketë një vlerë prej minimumi 120 Bilionë Euro – Bonusi i familjes në vlerën prej 600 Euro**

**Ministri i Ekonomisë Pinkwart: Dalje e shpejtë dhe e qëndrueshme nga kriza me rritjen e re – Investime në inovacion, dixhitalizim dhe në mbrojtjen e klimës me qëllim modernizimin e Republikës**

**Qeveria e Republikës ju komunikon:**

Ekonomia gjendet në krizën më të rëndë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore: Njëlloj si e gjithë Gjermania, Nordrhein-Westfalen është masivisht e afektuar nga pandemia e koronavirusit. Në mënyrë që të kapërcehet kriza dhe të mëkëmbet ekonomia shpejt, nevojiten kontribute madhore nga federata, republika dhe BE. Në lidhje me këtë, qeveria e republikës po mundëson 10 stimuj për të forcuar ekonominë dhe zhvillimin, të cilat do të shërbejnë gjithashtu si program modernizimi për Gjermaninë dhe Nordrhein-Westfalen.

Kryeministri Armin Laschet: „Së bashku me qeverinë e Republikës dhe BE ne duam të ngrejmë një program modernizimi dhe të mundësojmë një shtysë të vërtetë për modernizim. Qeveria e Republikës sheh një nevojë kombëtare prej minimumi 120 Bilionë Euro, për të patur një paketë efektive stimuli ekonomik dhe modernizimi. Në situatën e tanishme, është veçanërisht e rëndësishme që të gjitha përfitimet dhe shpenzimet publike të mund të vazhdojnë në të gjitha nivelet në korrespondim me planet fiskale afatmesme. Kjo është veçanërisht e vërtetë për komunitet, të cilët janë investitorët më të mëdhenj publikë. Për shkak të mbylljes së shkollave dhe të qendrave të kujdesit ditor për fëmijë në javët e fundit, familjeve u është dashur të durojnë dhe po durojnë ende pengesa të veçanta. Si rrjedhim ne propozojmë një bonus familiar të vetëm prej 600 Euro për secilin fëmijë, për të lehtësuar barrën dhe për të mbështetur konsumin shtëpiak.“

22.05.2020  
Seite 1 von 2

Pressestelle Staatskanzlei  
40213 Düsseldorf  
Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
oder 0211 837-1151

[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)  
[www.land.nrw](http://www.land.nrw)

Ministri i Ekonomisë Prof. Dr. Andreas Pinkwart: „Nëse duam të dalim më të fortë nga kriza, duhet të veprojmë tani me vendosmëri. Me masa të cilat janë menjëherë efektive dhe në të njëjtën kohë ofrojnë dobinë e dyfishtë të mbrojtjes së qëndrueshme të mjedisit dhe të inovacioneve të forta. Lehtësimi i taksave dhe kapitali i rritjes më i madh mund të ndihmojë me forcimin e fuqisë inovative të kompanive dhe të sjellë përpara investimet e nevojshme në dixhitalizim dhe në teknologjitë miqësore ndaj klimës dhe të kursimit të burimeve dhe energjisë. Projekte të reja infrastrukture për lëvizjen dixhitale dhe neutrale ndaj klimës dhe për industrinë e së ardhmes duhet të promovohen masivisht tani. Burokraci e pandërlikuar me procedura të shpejta aprovimi, arsimim dhe kërkim më i mirë dhe stimuj me synim inovacionin dhe mbrojtjen e klimës janë leva të rëndësishme për rritjen e re të qëndrueshme .“

Bazat për dhjetë stimujt e qeverisë së Republikës janë rekomandime të instituteve kërkimore RWI dhe IW.

Shkarko raportet e instituteve ekonomike dhe dhjetë stimujt:

[www.wirtschaft.nrw/pressemitteilungen/10-Impulse-Konjunktur](http://www.wirtschaft.nrw/pressemitteilungen/10-Impulse-Konjunktur)

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

***[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave](#)***